



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

34	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	24.03.2021 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	Besa Ferati
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Drejtorët: Drin Sadikaj, Enver Rugova, Hysni Maxharraj, Hazbi Bajra, Edona Bujupi Loxha, Zyrtar Administrativ: Isa Hoxha, Zekije Sutaj, Ardon Arifaj, Flora Bujupaj, Fjollë Berisha.
Rendi i ditës: <ol style="list-style-type: none">1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Komitetit,2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 26.02.2021,3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin fiskal 2020,4. Shqyrtimi i Raportit të punës 6 mujor të NK. "Stacioni i Autobusëve",5. Raportimi për planet e Efiçencës për vitin 2020,6. Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha,7. Plani i Veprimit për ZKA (Zyrën Kombëtare të Auditimit për 2019,8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit 01 Nr.75/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore,9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit 01 Nr.76/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore,10. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave.11. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.	
Diskutimet:	

Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj - përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjerë janë pajisur me maska, dorëza dhe dezinfektues në tavolina.

Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje apo sugjerim para miratimit të rendit të ditës;

Enver Rugova - përshëndet të gjithë të pranishmit dhe kërkon që pika e 10 e rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme sepse pas dëgjimit publik i cili është mbajtur me 18,03,2021 propozuesit e kësaj Rregullorja nuk janë pajtuar me disa nene të cilat kanë hy në Rregullore nga komisioni .

Zenel Shatri -përshëndet të gjithë të pranishmit, pajtohem me drejtorin që kjo Rregullore të shtyhet të punohet me mirë.

Eliot Kukiqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, pajtohem edhe ne të shtyhet të jetë një Rregullore e punuar mirë dhe me kohë.

Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj - pasi që propozimin e drejtorit po e mbështesni të gjithë, Hedh në miratim që kjo Rregullore të hiqet nga rendi i ditës.

Miratohet një zëri që të hiqet pika e 10 nga rendi i ditës.

Hedh në votim rendin e ditës.

Miratohet rendi i ditës unanimit.

Vendimet:

Miratohet rendi i ditës në mënyrë unanime.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj- Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, Konstatohet që prezent janë 6 anëtar të Komitetit për Politikë e Financa, përveç Besa Ferati e cila ka lindur, Kuorumi është dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.

Vendimet:

Vazhdojmë me mbledhjen

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. a ka dikush diçka?

Pasi që diskutime nuk pati hedh në miratim.

Miratohet një zëri procesverbali nga mbledhja e kaluara.

Vendimet:

Miratohen njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin fiskal 2020, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ja kaloj fjalën Zyrtarit Kryesor Financiar z. Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Raportin financiar për vitin fiskal 2020.

Eliot Kukiqi - vërejtjet e kemi pasur gjithnjë të projektet kapitale, drejtori tha se mjetet po dalin me kohë ndërsa, shqetësimi im është pse po mbesin projektet kapitale çdo vit koxha një shifër e madhe.

Zenel Shatri - përshëndet të gjithë të pranishmit, të planifikuara për të hyrat vetanake 1.1miljon , 9.1 janë realizuar ku qëndron arsyeja e mos realizimit të tyre. Drejtorit kryesore paskan me së shumti suficit, mendoj qe kanë mundur me i shfrytëzuar në mënyrën me të mirë e me racionale unë e di së për çdo ditë po shkojnë e po bëjnë ankesa profesorët qe po dalin në pension të ju ipet paga shtesa e jo të obligohen ata ta marrin me përmbaruese. Vërejtje gati për të gjitha drejtorit le të punojnë me mirë se nuk është e udhës edhe pse po i marrin parasysh qe është vit sfiduese vit i pandemisë pastaj, sidomos në shëndetësi me mbet suficit është shqetësuese.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, po pajtohem plotësisht me mendimin e doktorit atje se vërtet është shqetësuese po pse ne nuk po na bie ndërmend para se me shkuar në suficit ato sende me i dedikuar nëpër kërkesat të cilat janë, po flasë për fushën e arsimit të gjitha kërkesat tona kanë qenë edhe nuk janë përmbushur.

Zenel Shatri - lutë kryesuesin dhe nënkryetarin që në mbledhje të vine të gjithë drejtorët që të mund ti bëjmë ne pyetje, dhe në mbledhjen e Kuvendit të na japen sqarimet.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj - hedhe në miratim

Miratohet një zëri nga anëtarët prezent të KPF-së

Haki Podrimaj - Drejtori Enver Rugova me luti qe të kërkoj qe të shtyhet pika e 4 për shkak se

drejtorit ju desh të ishte në një takim dhe besoj qe do ta përfundoj shpejt dhe te jetë këtu për ta prezentuar piken e parapar me rend dite.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: Raportin financiar për vitin fiskal 2020, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. ja kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: Raportimi për planet e Efiçencës për vitin 2020, raportin e keni pasur në material, prandaj unë rreth kësaj i jap fjalën zyrtarit për Efiçencë z. Isa Hoxha

Isa Hoxha - përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Raportin për planet e Efiçencës për vitin 2020.

Zenel Shatri - po dua qe të jeni me të qartë qe ne ti kuptojmë me mirë çka jeni tu bë për me i shfrytëzuar këto kredinë për me fitu të mira materiale që na vinë ne pa kamat e qe duhet me i kthye pas 15 vitesh ne si komunë qe 7 muaj ditë është nënshkruar kontrata a kemi punuar ndonjë gjë me e këqyr a kemi llogari me e bë atë a jo apo si i kemi punët. Raportimi për planet e Efiçencës për vitin 2020.

Isa Hoxha - 5 projekte kemi aplikuar dhe të pestat i kemi fituar, pasi që është realizuar kjo, në mes Kryetarit dhe fondacionit për pesë projektet për fillimin e procedurave, procedurat e tenderit dhe të gjitha janë të tyre. Prape është bere thirrja tjetër për 5 projekte tjera ne kemi aplikuar vetëm në tri projekte të cila edhe i kemi fituar, ku do me thëne me fondacionin në marrëveshje i kemi 8 projekte fondacioni ka mei përfunduar të gjitha punët.

Ajshe Metaj - pasi që është kompania e po qave u kuptua nga tema që poqët ndërrohen me qellim qe të kursehet rryma. Po me pëlqen shumë me u fituar energjia prej pllakave solare por sa kam informacion ky projekt është bukur i shtrenjtë. Pyete a keni punuar diçka në këtë drejtim në ndonjë objekt apo a keni pasur ndonjë program qe keni bërë diçka të tillë a jo për me e kuptuar ne se ndoshta vendosen se energjia e diellit është e pa pagueshme.

Isa Hoxha - të ndriçimi publik ne e kemi një kompani qe merret me mirëmbajtjen kohë pas kohe duke pasur parasysh erërat lagështinë Ledi është shumë i ndjeshëm edhe me ndërrimin e tensionit të rrymës ato po prishen shumë me shpejt se sa e kanë të planifikuar.

Kryesuesi i Kuvendit - z. Isa a miratohet ky raport a kanë nevojë anëtarët e Kuvendit ta miratojnë këtë raport.

Isa Hoxha - po duhet te miratohet.

Haki Podrimaj - zyrtari na sqaroi shumë mirë punë e mirë. Veg ju lutem qe paret të shpenzohen në

projekte qe ka nevoj e mos të shkojn paret në suficit.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi qe diskutime tjera nuk ka hedhe në miratim
Miratohet unanimit nga anëtarët e KPF-së

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: **Raportin për planet e Eficiencës për vitin 2020, ja kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, po vazhdojmë më pikën e katërtë të rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit të punës 6 mujor të NK. "Stacioni i Autobusëve", lidhur me këtë fjalën ja kalojë Drejtorit z. Enver Rugova .

Enver Rugova -përsëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës 6 mujor të NK. "Stacioni i Autobusëve".

Kryesuesi i Kuvendit - Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, i rekomandojnë Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportit të punës 6 mujor të NK. "Stacioni i Autobusëve".
Miratohet unanimit nga anëtarët e KPF-së.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF unanimit rekomandon: **Raportin e punës 6 mujor të NK. "Stacioni i Autobusëve", dhe të njëjtin ia kalon KK për shqyrtim dhe miratim**

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës: Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha, Edhe këtu e kemi pasur Rregulloren për rishqyrtim, fjalën ja kalojë drejtorit të drejtoratit për Buxhet dhe Financa, z. Hysni Maxharraj.

Hysni Maxharraj - përsëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Rishqyrtimit të Rregullores Komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha,

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj –pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.

Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që: Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 7.	
<p>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës , Plani i Veprimit për ZKA (Zyrën Kombëtare të Auditimit për 2019, fjalën ja kaloj drejtorit të drejtoratit për Buxhet dhe Financa, z. Hysni Maxharraj.</p> <p>Hysni Maxharraj - bënë prezantimin dhe sqarimin e Planit të Veprimit për ZKA (Zyrën Kombëtare të Auditimit për 2019.</p> <p>Ajshe Metaj – pyete rreth pronave të uzurpuara, a janë identifikuar të gjitha pronat e uzurpuara në komunë, a janë regjistruar çka është ber në këtë drejtim a është zvogëluar numri i pronave të uzurpuara nga aktiviteti i prokurorisë dhe policisë. Çka ka bere komuna në këtë drejtim.</p> <p>Hysni Maxharraj – pronat e uzurpuara janë evidentuar por me u regjistruar nuk munden,</p> <p>Drejtori i Drejtoris për Kadaster dhe Gjodezi z. Hazbi Bajraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kjo temë është shumë me rendësi ne po kemi takime të vazhdueshme me policin dhe prokurorin e shtetit, si dhe policin e komunës së Istogut komandantin z. Enver Gashi dhe është marr një vendim që komuna të filloj me evidentimin e pronave të uzurpuara. Raportet u janë dërguar Prokurorisë dhe Policisë , mirë po dikund pesë zona kadastrale që janë në komunën tonë kemi përfunduar duke pasur parasysh që për ditë mund të paraqiten edhe raste të reja, rastet të cilat janë përmes gj portalit po thuj se kanë përfunduar por po ka edhe raste tjera të reja. Kemi tri lloje të uzurpimeve me ndërtime, të mirave të ujërave dhe uzurpimet e rrugëve publike.</p> <p>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Plani i Veprimit për ZKA (Zyrën Kombëtare të Auditimit për 2019.</p>	
Diskutimet:	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që : Plani i Veprimit për ZKA (Zyrën Kombëtare të Auditimit për 2019, t'i kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 8.	
<p>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës , Shqyrtimi dhe</p>	

miratimi i propozim vendimit 01 Nr.75/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore, fjalën ja kaloj drejtorit z. Jashar Blakaj.

Jashar Blakaj – përsëritet të gjithë të pranishmit, bën prezanton dhe sqarimin e Propozim Vendimit 01 Nr.75/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore,

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj –pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Propozim Vendimit 01 Nr.75/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që : Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit 01 Nr.75/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore, t'i kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e nënte të rendit të ditës , Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit 01 Nr.76/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore, fjalën ja kaloj drejtorit z. Jashar Blakaj.

Jashar Blakaj –bënë prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit 01 Nr.76/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore.

Ajshe Metaj – dua të di ku është lokacioni ku gjinden këto dy prona.

Jashat Balakaj – është rruga regjionale Gurrakoc të Llukafci i Thatë afër rruge, është një ngastër kadastrale që është bërë ndarjen ndarja para disa viteve në disa pllace ku do t; ndërtohen disa objekte individuale. Është tokë private.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj –pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Propozim Vendimit 01 Nr.76/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që : Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit 01 Nr.76/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrim destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore, t'i kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 11.	
<p>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e njëmbëdhjete të rendit të ditës , Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, fjalën ja kaloj drejtoreshës së drejtoratit për Administratë, z. Edona Bujupi Loxha.</p> <p>Edona Bujupi Loxha - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.</p> <p>Po ashtu kanë ardhur edhe disa propozime nga zyrtarja ligjore, për shkak që ju nuk i keni ato propozime dhe që kjo Rregullore të korrigjohet edhe një here me këto propozime kërkoj që të shtyhen për mbledhjen e ardhshme.</p> <p>Zenel Shatri - të shtyhet të rregullohet mirë pastaj të vjen në Kuvend asgjë për nguti nuk e kemi.</p> <p>Ajshe Metaj - edhe unë pajtona me kolegun që të shtyhet kjo Rregullore për mbledhjen e ardhme që të mund edhe këto propozime të i qesin.</p> <p>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj - pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të mos të i dergohet për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës</p>	
Diskutimet:	
Vendimet:	
<p>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që mos ti kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim: Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.</p>	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Diskutime tjera:	
<p>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.</p> <p>Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.</p>	
Mbledhja përfundoj :	12:11

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj




Kryesuesi i Kuvendit,
z. Qaush Balaj

